

34179; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; Gjykata e Qarkut Prishtinë, C. Br. 425/2001 (Latif Gashi dhe të tjerë), aktgjykimi, 16.07.2003, FDH-1840; SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 151-157; *Perkujtohem deshmoret Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi*, pasqyra e lajmeve, 03.12.2009, <http://www.zemrashqiptare.net/article/Reportazh/11595/>; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

---

### **Bojan (Mile) Randelović**

(26.09.1973, serb nga Zajeçari, student, pjesëtar i Ushtrisë Jugosllave)

Bojani ishte student i vitit të tretë në Fakultetin Elektroteknik në Nish. Ai jetonte me prindërit Mileta dhe Zlatica dhe gjyshen Rozmirka. Në muajin dhjetor të vitit 1997, u lajmërua për shërbimin e rregullt ushtarak. Një kohë shërbeu në kazermën në Uzhicë, ndërsa më 8.06.1998, njësi i tij

u risistemua në kazermën *Heronjtë e Kosovës/Kosovski junaci* në Prishtinë/Priština. Çdo ditë bisedonte me telefon me prindërit e vet. Dy herë në javë, shkonte në rojë në **Gračanicë/Gračanica**. Në datën **8.12.1998**, iu lajmërua prindërve dhe u tha se në atë ditë do të shkonte për herë të fundit në rojë [kah mesi i dhjetorit e përfundonte shërbimin ushtarak]. Në të njëjtën natë, familjarët u informuan se Bojani u vra në vendin e rojës. Familjarët trupin e Bojanit e kishin marrë të nesërmen dhe në ballin e tij vëreheshin gjurmë nga plumbi. Në certifikatën e Ushtrisë së Jugosllavisë shkruante se Bojani kishte kryer vetëvrasje, duke shtënë në gojë. Familjarët e varrosën Bojanin më 10.12.1998 në varrezat e qytetit në Zajeçar.

**Burimet:** deklarata M.R, FDH-21801; S. Popović, *Branioci...*, 65-70; MMRS, *Regjistri i pjesëtarëve...*, FDH-28075.

---